



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri (JR) 15/2018
Nr. 15/3 regj.

Tiranë, më 09.01.2019

SHPALLJE

E

**NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË
PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se sot, më datë 09.01.2018, ora 10.00, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen me numër regjistri (JR) 15/2018, datë 11.09.2018, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Artan Lazaj kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 34, datë 11.07.2018, bazuar në nenin 4, pika 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 51, pika 1, germa “b” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, ditën **e mërkurë**, në datën **23.01.2019**, ora **10:00**.

Gjykimi në seancë publike u vendos për të debatuar, nëse shkelja e rëndë procedurale e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në ankim, për mosshqyrtimin e kërkesës së tij për përjashtimin e Komisioneres Brunilda Bektoshi nga shqyrtimi i çështjes, nga një tjetër trup gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikuar, i ndryshëm nga trupi gjykues që ka dhënë vendimin nr. 34, datë 11.07.2018, ka ndikuar ose jo në bazueshmërinë e këtij vendimi.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjykues	Sokol Çomo
Relator i Çështjes	Albana Shtylla
Gjyqtar	Ardian Hajdari
Gjyqtare	Natasha Mulaj
Gjyqtare	Rezarta Schuetz



Bazuar në nenin 460, pika 5 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 51, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

RELATORI I ÇËSHTJES

GJYQTAR

Albana Shtylla



KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES

GJYQTAR

Sokol Çomo